

Dihet që çdo femër e ka merak pastërtinë e shtëpisë, por nuk mund ti lejojë vetes të humbasë orë të tëra vetëm me pastrimin. Ladyalbani.al në këtë artikull do tju tregojë disa rregulla magjike se si ta realizoni pastrimin sa më shpejt dhe në mënyrën sa më efektive.



Rregulli №1. Hidhni gjërat e tepërta

Të eliminosh gjërat e panevojshme - është vetëm gjysma e punës. E rëndësishme është se si të risistemosh vendin e liruar e mos ta zësh atë sërish me gjëra që nuk duhen.

Thonë se mashkulli paguan 2 herë më shumë për gjënë që ka me të vërtetë nevojë, ndërsa femra me kënaqësi e blen një gjë, nëse kushton sa gjysma e çmimit normal, pavarësisht se sa të nevojshme e ka gjënë që po blen.

Prandaj këshillojmë që ti vendosni të gjitha këto gjëra të panevojshme por që nuk janë as për ti hedhur poshtë në kutira e ti vendosni diku në dollap. Ato gjëra janë aty e ju mund ti nxirrni nga kutitë kur të keni sërish nevojë për to.



Rregulli №2. Çdo gjë në vendin e vet

Mëso të vendosësh në vendin e vet çdo gjë që përdor, duke i lehtësuar punën vetes. Mundohu të edukosh edhe të tjerët me këtë kulturë duke eliminuar kështu rrëmujën.

Ju mund të kurseni kohë duke i vendosur psh. këpucët dhe rrobat pas punës direkt në vendin e tyre. Gjithashtu bëni një delegim të punëve tek pjesëtarët e familjes, në mënyrë që gjithësecili të kujdeset për rregullin e gjërave të veta.

Duke vendosur rregull, ju e keni shtëpinë të sistemuar dhe çdo gjë e gjeni më të lehtë, pa i kthyer gjërat përmbys për të gjetur gjëra dhe rroba që sju kujtohet se ku i keni lënë herën e fundit.



Rregulli №3. Bëni kujdes për mirëmbajtjen e gjërave që blini

Para se të blini sende apo mobilje për shtëpinë kini parasysh se sa kujdes ato kërkojnë në mirëmbajtje dhe pastërti. Ka disa copa dhe materiale, sidomos kur flitet për divanet, perdet, kolltukët etj që kërkojnë një pastrim tepër specifik e që ju marrin shumë kohë. Prandaj bëni shumë kujdes në përzgjedhjen e tyre, ose blini materiale që janë më të lehta në pastrim.

Për kolltukët dhe divanet rekomandohet që të përdorni mbulesa, të cila mund të lahen në lavatriçe. Përsa i përket tapeteve dhe qilimave, përdorni materiale që lahen shpejt ose që pastrohen në pastrim kimik. Evitoni përdorimin e tapeteve në vendet ku shpesh mund të kaloni me këpucë, e përdorni aty rrugica të lehta e të vogla që lahen e pastrohen shpejt.



Rregulli №4. Elektroshtëpiakët janë të domosdoshme!

Dihet që dembelizmi është promotor i progresit. Siç ka thënë Lech Welsa " Ishin dembelët ata që shpikën karrocën dhe biçikletën pasi nuk ju pëlqente të ecnin apo të mbanin tesha". Prandaj edhe elektroshtëpiakët janë të domosdoshëm për të pasur një pastërti sa më të mirë e për ti mbaruar sa më shpejt punët e shtëpisë.

Kujdesuni që fshesa juaj me korrent të jetë e mirë dhe e fuqijshme, përndryshe tapetet tuaja

nuk do të shkëlqejnë nga pastërtia. Lavatriçja dhe lavastovilja janë gjithashtu tepër të nevojshme për ti pasur rrobat dhe enët gjithmonë të pastra. Mundohuni të blini gjithmonë gjërat më cilësore dhe të dobishme për pastërtinë e shtëpisë pasi ato ju lehtësojnë punën dhe ju kursejnë shumë kohë.



Rregulli №5. Ndryshoni këndvështrimin dhe marrdhënien me veten!

Rregulli më i thjeshtë për të ndryshuar marrdhënien tuaj me pastërtinë - është marrdhënia juaj me veten. Po, po, me veten. Nëse jeni vetëm në shtëpi e keni shumë punë për të bërë, prisni një herë, mos vraponi të rendni pas punëve pasi ato nuk mbarojnë asnjëherë. Duhet të mësoheni që ti kushtoni kohën e duhur vetes dhe ta ktheni pastrimin e shtëpisë në orë argëtimi e jo pune. Kini parasysh që punët e shtëpisë janë një anti-stres shumë i mirë. Shijoni çdo moment të pastrimit, gatimit, hekurosjes etj, e do ta shihni se punët nuk do tju duken më një barrë e rëndë që duhet hequr.

E rëndësishme është që mos ti bësh punët dhe sistemimin pa humor, por vetëm kur të ndiheni mirë shpirtërisht dhe fizikisht e ti shijoni orët që kujdeseni për shtëpinë. Nëse ka raste kur keni shumë punë e nuk i përballoni dot vet, kërkoni ndihmë ose punësoni dikë që tju ndihmojë.